



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 308, datë 29.4.2026

P Ë R

**KALIMIN E FONDIT PËR T'U PËRDORUR NË FORMËN
E KAPITALIT FILLESTAR PËR SHOQËRINË "ALBANIAN DIGITAL
SOLUTION", SH.A.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, të ligjit nr.87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", të nenit 44, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 23, pika 1, e 24, pika 1/1, të ligjit nr.43/2023, "Për qeverisjen elektronike", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kalimin e fondit, në masën 700 000 000 (shtatëqind milionë) lekë, për t'u përdorur në formën e kapitalit fillestar për shoqërinë "*Albanian Digital Solution*", sh.a., me NIPT M61615021U.
2. Fondi i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi përballohet nga buxheti i miratuar për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, për vitin 2026, në zërin "Shpenzime kapitale".

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe shoqëria “*Albanian Digital Solution*”, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ALBANA KOÇIU

MINISTRI I EKONOMISË
DHE INOVACIONIT

DELINA IBRAHIMAJ

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSMINISTRI

ENKELEJD MUSABELLIU

NR.PROT. 2538/1
DATË 4.5.2026

MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT
MINISTRISË SË FINANCAVE
AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË
INFORMACIONIT
SHOQËRISË "ALBANIAN DIGITAL SOLUTION", SH.A.
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Elsonida RAMA

